



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

BORDI DREJTUES

Nr. 208/15 Prot.

Tiranë, më 24.05.2019

V E N D I M

Nr. 4, datë 24.05.2019

Bazuar në ligjin nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare", neni 20, Bordi Drejtues i Institutit të Statistikave në mbledhjen e datës 23.05.2019

VENDOSI:

1. Miratimin e Kodit të Etikës sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ngarkohen të gjithë punonjësit e INSTAT për zbatimin e Kodit Etik të miratuar me këtë vendim;
3. Ngarkohet Zyra e protokollit për shpërndarjen e Kodit Etik tek të gjitha Drejtoritë e institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT DREJTUES

DELINA IBRAHIMAJ



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta", Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

**KODI I ETIKËS
I
INSTITUTIT TË STATISTIKAVE
(INSTAT)**

Tiranë, Maj 2019

Përmbajtje

KREU I.....	6
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	6
1. Qëllimi	6
2. Fusha e veprimit.....	6
3. Përkufizime	7
4. Parime të përgjithshme	7
KREU II.....	8
STANDARDET BAZË TË SJELLJES	8
5. Integriteti	8
6. Paanshmëria	8
7. Maturia	9
8. Etika.....	9
9. Sjellja etike	9
KREU II.....	10
SJELLJA BRENDA INSTITUTIT TË STATISTIKAVE	10
10. Detyra për të qenë besnik ndaj institucionit	10
11. Paraqitja në punë, mirësjellja dhe respekti	10
12. Diversiteti	10
13. Përgjegjësia	11
14. Përdorimi i pronave, i pajisjeve dhe i burimeve të INSTAT.....	11
15. Zgjidhja e problemeve dhe e konflikteve personale.....	11
16. Hakmarrja.....	11
17. Privatsia.....	11
18. Ekuilibri Punë-Familje	12
KREU IV	12
PËRDORIMI DHE PËRHAPJA E INFORMACIONIT	12
19. Përdorimi dhe përhapja e informacioneve të klasifikuara	12
20. Marrëdhëniet me median, deklaratimet publike dhe publikimet	12
KREU V	13
KONFLIKTET E INTERESAVE	13
21. Konfliktet e interesave	13
22. Detyrimi për të deklaruar informacione mbi veten	14
KREU VI	14

ETIKA E TITULLARIT TË INSTAT, STANDARDET BAZË TË SJELLJES DHE INTEGRITETI PERSONAL	14
23. Drejtori i Përgjithshëm si titullar i INSTAT	14
24. Ndershmëria dhe paanshmëria	15
25. Mosdiskriminimi.....	15
26. Daljet në publik	15
27. Pavarësia	16
28. Paanësia politike	16
29. Përdorimi dhe përhapja e informacioneve jopublike	17
30. Konfliktet e interesave	17
KREU VII	18
AKTIVITETET E JASHTME DHE TË TJERA	18
31. Punësimi jashtë Institutit të Statistikave	18
32. Aktivitete të tjera të jashtme	18
33. Dhuratat, argëtimet, shpërblimet për punonjësit	19
34. Nepotizmi.....	19
35. Zbatimi i orarit të punës.....	20
KREU VIII	21
STRUKTURA MBIKQYRËSE E ETIKËS	21
36. Struktura Mbikqyrëse e Etikës	21
37. Deklarimi i njohjes së detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i rregullave	21
38. Dispozita zbatuese	21
39. Publikimi dhe hyrja në fuqi	21

Preambul

Në mbështetje të Ligjit Nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, aktet nënligjore që rregullojnë çështje të etikës, si dhe bazuar në standardet ndërkombëtare të etikës dhe integritetit të punonjësve, hartohet ky kod mbi etikën dhe sjelljen profesionale të punonjësve të Institutit të Statistikave.

Ndonjëherë, punonjësi mund të konstatojë se sjellja e përshtatshme në një situatë të dhënë nuk është e qartë. Ky kod mund të ndihmojë lidhur me atë që mund të vendoset të bëhet nga punonjësi në shumë, por jo në të gjitha situatat. Kur punonjësi dyshon lidhur me implikimet etike të një veprimi, mund të kërkojë këshilla më parë se të veprojë.

Dhe gjithnjë duhet të pyesë veten (lidhur me veprimet e tij):

- A janë të ligjshme?
- A e ndjen se vepron drejt?
- A ndikojnë veprimet e tij negativisht apo pozitivisht tek ai opo tek Instituti i Statistikave?
- Çfarë do të mendonte një person i arsyeshëm lidhur me veprimet e tij?
- A do të ndjehej në pozitë të vështirë nëse të tjerët do të njiheshin me veprimin që po kryen?
- A ekziston ndonjë veprim tjetër, i cili nuk nxjerr në pah një konflikt etik?

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi

- (A) Ky kod ka si qëllim që të shërbejë si udhëzues për të gjithë stafin e Institutit të Statistikave lidhur me veprimet e përditshme apo me ato vendimmarrëse në përputhje me misionin, parimet që na udhëheqin dhe vlerat tona bazë. Ai nuk pretendon se përmban të gjitha përgjigjet lidhur me çdo problem etik që mund të lindë. Kodi nuk është zëvendësues i gjyqimit të shëndoshë dhe nuk eliminon apo mënjanon, rregulloret e ndryshme të zbatuara në Institutin e Statistikave. Ai shërben si një urë lidhëse ndërmjet dëshirave dhe veprimeve të përditshme dhe shpreh ndjenjën e angazhimit kundrejt misionit të Institutit të Statistikave. Kodi është, gjithashtu, një mjet për të inkurajuar diskutimet lidhur me etikën dhe për të përmirësuar qëndrimet apo reagimet në punë (ato reagime që lidhen me mëdyshjet dhe paqartësitë etike).
- (B) Qëllimet e Institutit të Statistikave kërkojnë që gjithkush që punon për këtë institucion, të respektojë apo të zbatojë standardet më të larta të etikës. Stafi i institucionit duhet të ketë përgjegjësi për të kontribuar në qeverisjen e mirë të Institutit të Statistikave dhe të ndihmojë në përmirësimin e imazhit dhe mbajtjen lart të emrit të mirë të tij.
- (C) Instituti i Statistikave do të përpiqet të nxisë dhe të mbajë një mjedis pozitiv pune të tillë që të mbështesë sjelljen etike brenda tij. Drejtuesit e Institutit të Statistikave do të inkurajojnë në mënyrë aktive dialogun etik, do të ofrojnë drejtim apo këshillim nëpërmjet programeve, materialeve trajnuese apo burimeve të tjera si edhe do të sigurojnë që sistemet, politikat dhe procedurat e brendshme të Institutit të Statistikave të jenë në përputhje të plotë me qëllimet etike të këtij institucioni, shumë të rëndësishëm.
- (D) Moszbatimi i rregullave të kërkuara në këtë Kod dhe i rregullave apo i rregulloreve të Institutit të Statistikave të lidhura me të, përbën arsye për veprime disiplinore nga Instituti i Statistikave. Kur shkeljet konsiderohen serioze (pra të përsëritura) mund të shkaktojnë edhe përfundimin e marrëdhënieve me Institutin e Statistikave. Gjithkush ka të drejtë që të paraqesë këndvështrimin e tij lidhur me shkakun e përfundimit të marrëdhënieve dhe, në rastin e mosqënies dakord, ka të drejtë të apelojë vendimin përkatës.
- (E) Rregullat dhe parimet e përcaktuara në këtë Kod janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga gjithë punonjësit e Institutit të Statistikave pavarësisht nivelit dhe hierarkisë së funksionit që ata ushtrojnë.

2. Fusha e veprimit

Rregullat dhe parimet e përcaktuara në këtë Kod janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë punonjësit e INSTAT, pavarësisht nivelit të pozicionit të punës, hierarkisë dhe funksionit që ato ushtrojnë.

3. Përkufizime

3.1 “staf” - Me termin “staf” në Institutin e Statistikave do të kuptojmë tërësinë e punonjësve të tij, “personelin”, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe.

3.2 “etikë” - Etika ndihmon që titullari i institucionit dhe stafi i Institutit të Statistikave të përcaktojnë rolin dhe përgjegjësitë, si në lidhje me vetveten, ashtu edhe me kolegët, me partnerët apo me institucionin.

3.3 “sjellje etike”- Sjellja etike nuk është një proces pasiv, por kërkon që stafi i Institutit të Statistikave të bëjë zgjedhje të ndërgjegjshme, të marrë vendime po të tilla, si edhe të gjykojë në mënyrë të shëndoshë, në përputhje me vlerat e Institutit të Statistikave që materializohen në këtë kod.

3.4 “integritet”- Në Institutin e Statistikave, me fjalën “integritet” do të kuptohet ndershmëria, korrektesa, drejtësia dhe besnikëria kundrejt punës, kolegëve dhe institucionit. Kërkohej që punonjësi të veprojë me integritet gjatë gjithë veprimtarisë së tij zyrtare dhe të shmangë çfarëdolloj sjelljeje që mund ta prezantojë ndryshe atë ose Institutin e Statistikave.

4. Parime të përgjithshme

4.1 *Parimi i ligjshmërisë.* Punonjësi i INSTAT-it duhet të zbatojë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e brendshëm, në përputhje me kompetencat që ai mbulon.

4.2 *Parimi i paanshmërisë, ndershmërisë profesionale, pavarësisë financiare dhe efektivitetit.* Në ushtrimin e funksionit të tij, punonjësi duhet të jetë i paanshëm, i drejtë, i arsyeshëm dhe i pavarur. Ai duhet të shmangë çdo veprim, mosveprim arbitrar apo çdo trajtim preferencial, si dhe të jetë i pandikuar nga çdo interes tjetër, personal, politik, familjar dhe shoqëror.

4.3 *Punë e përbashkët në grup* e bazuar në sinqeritet dhe në besim reciprok.

4.4 *Dhënie mundësie zhvillimi* të tjerëve dhe respektim i diversiteteve.

4.5 *Inkurajimi* i marrjes përsipër dhe i përballimit të sfidave dhe përgjegjësi.

4.6 *Objektiviteti.* Punonjësi i INSTAT-it, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, duhet të marrë në konsideratë faktorët përkatës dhe t'i japë secilit prej tyre peshën e duhur në qëndrimin përfundimtar, duke përjashtuar çdo element që nuk i përgjigjet procesit konkret të punës.

4.7 *Transparenca dhe llogaridhënia.* Punonjësi i INSTAT-it, nëse e kërkon interesi publik dhe kur kjo nuk është në kundërshtim me ligjin, informon dhe përgjigjet kur është rasti për të gjithë veprimtarinë e tij si funksionar publik.

4.8 *Konflikti i interesit.* Punonjësi i INSTAT-it duhet të parandalojë, si dhe të marrë të gjitha masat për ndërprerjen e gjendjes së konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave të tij private.

4.9 *Mosabuzimi me funksionin.* Punonjësi i INSTAT-it e ushtron funksionin dhe kompetencat e tij vetëm për qëllimin që ato i janë dhënë nga legjislacioni në fuqi. Ai duhet të shmangë përdorimin e funksionit të tij për qëllime, të cilat nuk kanë bazë ligjore apo nuk janë të motivuara nga ndonjë interes publik.

KREU II

STANDARDET BAZË TË SJELLJES

Si anëtarë të stafit të Institutit të Statistikave, kërkohet që punonjësit të zbatojnë standardet më të larta të sjelljes etike, në përputhje me vlerat e integritetit, të paanshmërisë dhe të maturisë. Punonjësit duhet të përpiqen të shmangin qoftë edhe dukjen e të qenurit i pahijshëm në sjelljen e tyre. Gjatë kryerjes së detyrës, stafi është i detyruar t'i qëndrojë, mbi të gjitha, besnik Institutit të Statistikave, objektivave, qëllimeve dhe parimeve të tij.

5. Integriteti

5.1 Instituti i Statistikave respekton privatësinë e punonjësit dhe nuk dëshiron që të ndërhyjë në jetën personale të tij, apo në sjelljet e tij brenda dhe jashtë vendit të punës. Instituti i Statistikave i kushton rëndësi të madhe zbatimit të të gjitha akteve ligjore e nënligjore në fuqi nga ana e punonjësit, sikurse edhe shmangies së veprimeve që mund të perceptohen si shpërdorim i imazhit që ka Instituti i Statistikave dhe stafi i saj; shkujdesjet në këtë drejtim do të reflektohen në marrëdhëniet e punonjësit me Institutin e Statistikave.

5.2 Instituti i Statistikave do të jetë, gjithashtu, i vëmendshëm lidhur me sjelljet e pahijshme, botërisht të shprehura, lidhur me dhunën në familje apo me abuzimin me anëtarët e familjes.

5.3 Nëse shqetësimet lidhur me sjelljen e punonjësit jashtë vendit të punës janë përçarur në vëmendjen e INSTAT-it nga një palë e tretë, atëherë Instituti Statistikave do të vejë në dijeni punonjësin lidhur me problemin në fjalë dhe do të kërkojë sqarime të mëtijshme nga ai për të shqyrtuar rastet nëse kemi të bëjmë me thyerje të rregullave të etikës në dëm të imazhit të institucionit.

5.4 Nuk është detyrë e Institutit të Statistikave që të përcaktojë nëse punonjësi ka shkelur apo jo ligjet në fuqi, objekti i të cilëve nuk është ai i statistikave zyrtare; kjo i përket gjykatës. Sidoqoftë, nëse Instituti i Statistikave merr një urdhër për të përmbushur një detyrim ligjor nga gjykata apo nga çdo autoritet tjetër, që ka forcën ekzekutive të një detyrimi financiar lidhur me mbajtjen e një pjese të pagës së një anëtari të stafit të tij, ai do ta zbatojë atë.

6. Paanshmëria

6.1 Stafi i Institutit të Statistikave duhet të veprojë me paanshmëri. Çdo punonjës duhet të tregojë kujdes që shprehja e pikëpamjeve dhe e konsideratave të tij personale të mos kompromentojë apo të duket se kompromenton rezultatet e detyrave të ngarkuara apo interesat e Institutit të Statistikave.

6.2 Sjellja zyrtare e punonjësit duhet të karakterizohet gjithnjë nga objektiviteti dhe profesionalizmi.

7. Maturia

7.1 Si anëtar i stafit të INSTAT-it, punonjësi duhet të tregojë maturinë më të madhe gjatë veprimeve të tij, si dhe të jetë i rezervuar në deklaratimet që bën, në përputhje me statusin e tij në INSTAT.

7.2 Punonjësi duhet t'i shmanget pjesëmarrjes në çdo aktivitet që bie në kundërshtim me interesat e Institutit të Statistikave apo që mund të dëmtojnë reputacionin e tij.

7.3 Punonjësi duhet të respektojë dhe të ruajë sekretin e informacionit të mësuar apo të vënë në dispozicion tek ai, si pasojë e pozicionit në hierarkinë zyrtare apo të të qenit pjesë e stafit të INSTAT-it.

8. Etika

Në Institutin e Statistikave, etikë do të thotë që stafi të:

- Përkrahë si formalisht, ashtu edhe shpirtërisht, frymën që përçojnë parimet, rregullat dhe udhëzimet që zbatohen në Institutin e Statistikave;
- Nxisë përgjegjshmërinë;
- Eliminonjë mungesën e respektit ndaj të tjerëve, padrejtësitë dhe pandershmeritë;
- Inkurajonjë dialogun, diskutimet e hapura dhe të paparagjykuara;
- Punojë me ndershmëri dhe të mësojë nga gabimet e mëparshme;
- Respektojë standardet bazë të sjelljes si brenda ashtu dhe jashtë mjedisit të Institutit të Statistikave;
- Jetë krenar për atë që është arritur dhe se si është arritur;
- Jetë modest lidhur me atë që mund të përmirësohet dhe mënyrën se si mund të bëhet ajo.

9. Sjellja etike

Gjatë punës, stafi duhet të mbajë në mendje udhëzimet e mëposhtme bazë:

- Duhet të veprojë gjithnjë me ndershmëri, me përkushtim dhe me paanshmëri kur zbaton detyrat e ngarkuara;
- Asnjëherë nuk duhet të nxjerrë apo të përdorë privatisht ndonjë informacion të klasifikuar, të siguruar nëpërmjet punës individuale për ose në Institutin e Statistikave;
- Asnjëherë nuk duhet të transmetojë informacione statistikore apo tregues jashtë INSTAT-it, pa u shpallur publikisht në mënyrë zyrtare nga institucioni;
- Asnjëherë nuk duhet të japë informacione tek personat e paautorizuar mbi proceset e përpunimit dhe prodhimit të të dhënave statistikore, përveç rasteve kur ato janë të bëra publike nga vetë institucioni
- Duhet të shmangë aktivitetet e jashtme, të cilat në mënyrë të arsyeshme mund të perceptohen si konflikt interesash;
- Të trajtojë gjithnjë të tjerët në mënyrë profesionale dhe të edukuar.

KREU II

SJELLJA BRENDIA INSTITUTIT TË STATISTIKAVE

Vlerat bazë të paanshmërisë, të integritetit dhe të maturisë duhet të udhëheqin të gjitha aspektet e sjelljes së punonjësit gjatë punës.

10. Detyra për të qenë besnik ndaj institucionit

Punonjësi duhet të respektojë pozicionin e tij dhe të jetë i pavarur, duke mos pranuar asnjë udhëzim lidhur me performancën e detyrave të tij zyrtare nga asnjë burim tjetër jashtë INSTAT-it.

11. Paraqitja në punë, mirësjellja dhe respekti

11.1 Paraqitja e punonjësit në punë duhet të jetë e përshtatshme dhe e tillë që të shprehë:

- a) kujdesin dhe seriozitetin e vazhdueshëm për anën e tij pamore;
- b) nivelin e domosdoshëm të pastërtisë së tij personale;
- c) plotësimin e kërkesave të domosdoshme të veshjes në ambientet e INSTAT-it sipas rregullores së brendshme të institucionit dhe normave të tjera në fuqi;
- d) vëmendje në mënyrën e komunikimit dhe të qëndrimit në ambientet e INSTAT-it.

11.2 Punonjësi duhet t'i trajtojë kolegët (qofshin këta eprorë, të barabartë apo vartës) me mirësjellje dhe respekt, dhe nuk mund t'i ngacmojë (fizikisht apo me fjalë). Gjatë punës, ai duhet të shmangë edhe ato sjellje, që megjithëse nuk arrijnë në nivelin e ngacmimit apo të abuzimit, mund të krijojnë një atmosferë jomiqësore apo frike.

11.3 Do të konsiderohen si ngacmime dhe do të trajtohen si të tilla të gjitha ato fjalë apo sjellje që ndërhyjnë në mënyrë të paarsyeshme në punën e gjithkujt apo që krijojnë një mjedis pune frikësues (kërcënues), jomiqësor dhe fyes. Një vend pune i hapur dhe i besueshëm është thelbësor për efektivitetin e punës së punonjësit në Institutin e Statistikave si edhe për të ruajtur moralin e stafit.

11.4 Do të konsiderohen si ngacmime seksuale dhe do të trajtohen si të tilla të gjitha përpjekjet (avancimet) e padëshiruara seksuale, kërkesat për favore seksuale, ose të tjera sjellje (fizike ose me fjalë) me natyrë seksuale të cilat ndërhyjnë në mënyrë të paarsyeshme me punën, kushtëzojnë punësimin apo krijojnë një mjedis pune fyes, jomiqësor apo frikësues.

12. Diversiteti

12.1 Për shkak të karakterit që ka INSTAT, si institucion i administratës publike, dhe për shkak të vlerës që kjo administratë i jep diversitetit, duhet që punonjësi i INSTAT-it të veprojë me tolerancë, me ndjeshmëri, me respekt dhe me paanësi kundrejt kulturës dhe formimit të personave të tjerë, që nuk i kanë të njëjta me të.

12.2 INSTAT reagon ndaj çdo sjelljeje abuzive, e cila do të konsiderohet fyese për ambientin apo për persona konkretë.

13. Përgjegjësia

- 13.1 Punonjësi duhet të ruajë kornizat e autoritetit që i jep funksioni.
- 13.2 Punonjësi mbetet përgjegjës për detyrat që i delegon të tjerëve.
- 13.3 Punonjësi ushtron mbikëqyrje dhe kontroll të përshtashëm mbi gjithçka që lidhet me detyrën e tij.

14. Përdorimi i pronave, i pajisjeve dhe i burimeve të INSTAT

- 14.1 Me pronë të Institutit të Statistikave, kuptohet çdo pasuri e luajshme dhe e paluajshme që ka në përdorim, në gëzim dhe në disponim INSTAT.
- 14.2 Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Institutin e Statistikave, punonjësi duhet të mbrojë dhe të ruajë pronën e institucionit përfshirë këtu edhe dokumentacionin zyrtar.
- 14.3 Në funksion të përdorimit sa më efikas të burimeve që i janë vënë në dispozicion, punonjësi duhet që t'ia kushtojë kohën e punës vetëm aktiviteteve zyrtare të Institutit të Statistikave.

15. Zgjidhja e problemeve dhe e konflikteve personale

- 15.1 Eprorët direkt përkatës kanë përgjegjësi që të jenë të disponueshëm për anëtarët e stafit të varësisë, të cilët kërkojnë të ngrenë çështje apo shqetësime në konfidencë (vetëm për vetëm) dhe t'i trajtojnë me ndjeshmëri dhe paanshmëri situata të tilla.
- 15.2 Eprorët direkt përkatës duhet të krijojnë një atmosferë të tillë që anëtarët e stafit të varësisë të ndjehen të lirë të përdorin (pa patur frikë për ndëshkime), rrugët institucionale ekzistuese për zgjidhjen e problemeve apo të konflikteve të çdo lloji, si edhe të shprehin shqetësime lidhur me situatat problematike apo konfliktuale ku ndodhen ose ku mund të ndodhen, jo vetëm lidhur me marrëdhëniet e tyre brenda INSTAT-it, por edhe më gjerë.

16. Hakmarrja

- 16.1 Dëmtimi që pësohet si rezultat i akuzave të pabazuara dhe joserioze dekurajon stafin lidhur me sjelljen dhe me zbatimin e standardeve të larta etike.
- 16.2 INSTAT mbron stafin e tij në rastet kur ata bëhen objekt i akuzave të pabaza nga çdokush që mbetet i pakënaqur si pasojë e kryerjes së rregullt të detyrës prej tyre.
- 16.3 Liria dhe përgjegjësia për të ngritur probleme, çështje apo shqetësime është thelbësore për të fuqizuar stafin dhe për të ruajtur integritetin si institucion. Si pasojë, INSTAT do të mbrojë stafin nga hakmarrjet e çdo lloji, përfshirë edhe ato të ardhura si pasojë e qëndrimeve të mbajtura në rastin e ngritjes së problemeve dhe të shqetësimeve të ndryshme. Kjo përgjegjësi për të mbrojtur anëtarët e stafit brenda institucionit zbatohet lidhur me persona, të cilët çenojnë ose aplikojnë hakmarrjen kundër stafit gjatë zbatimit të detyrave.
- 16.4 Ankesat për hakmarrje trajtohen seriozisht dhe sqarohen menjëherë.

17. Privatsia

- 17.1 INSTAT respekton privatsinë e stafit.

17.2 Informacionet konfidenciale (përfshirë dosjet personale, shënimet mjekësore, informacione lidhur me hetime të ndryshme, si dhe masat disiplinore), nuk do të lejohet që të keqpërdoren, nuk do të zbulohen dhe do të lejohet që të njihen vetëm nga persona të autorizuar.

17.3 Instituti i Statistikave ruan konfidencialitetin e çdo informacioni në përputhje me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore.

17.4 INSTAT respekton privatsinë e punonjësve në punë dhe nuk do të kërkojë që të ndryshojë sjelljet personale të tyre deri kur këto sjellje nuk do të dëmtojnë rezultatet e punës, apo kur do të bien në kundërshtim me rregulloren e brendshme të institucionit.

18. Ekuilibri Punë-Familje

18.1 INSTAT respekton ekuilibrin punë-familje si një sfidë për arritjen e objektivave të paracaktuar dhe çmon përpjekjet dhe pasionin e çdo punonjësi për ruajtjen e këtyre raporteve.

18.2 INSTAT do të përpiqet që të krijojë një mjedis të brendshëm sa më të mirë që të jetë e mundur, në mënyrë që të mbështesë punonjësit për të arritur një ekuilibër sa më të efektshëm ndërmjet punës, jetës familjare dhe asaj personale.

KREU IV

PËRDORIMI DHE PËRHAPJA E INFORMACIONIT

19. Përdorimi dhe përhapja e informacioneve të klasifikuara

19.1 Punonjësit e INSTAT-it kanë përgjegjësinë të mbrojnë sigurinë e çdo informacioni të klasifikuar, të siguruar në Institutin e Statistikave apo të prodhuar prej tij.

19.2 Për të shmangur çdo përhapje të paautorizuar të informacionit, punonjësit duhet të jenë të kujdesshëm në mënyrën se si e përdorin atë.

19.3 Parimi bazë i rregullave dhe i udhëzimeve lidhur me sigurinë e informacionit është se informacioni i klasifikuar mund të komunikohet tek anëtarët e stafit vetëm në përputhje me ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” apo me aktet rregullative që lidhen me klasifikimin e informacioneve statistikore dhe konfidenciale në INSTAT.

19.4 Nuk lejohet marrja dhe dhënia e informacionit për përfitime të ndryshme ose kur përbën shkak për lindjen e konfliktit të interesave gjatë marrëdhënieve të punësimit në Institutin e Statistikave.

19.5 Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Institutin e Statistikave, punonjësit nuk duhet që në mënyrë të paautorizuar me ligj ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, ku INSTAT është palë:

- a) të lejojë zbulimin ose publikimin e informacioneve jopublike, të cilat i kanë përfituar nga kryerja e detyrave të tyre;
- b) të përdorë apo të lejojë që ky informacion të përdoret për përfitime personale.

20. Marrëdhëniet me median, deklaratimet publike dhe publikimet

20.1 Nëse nuk jeni të autorizuar ju nuk duhet që të jepni, të publikoni apo të nxirrni për përdorim publik materiale që kanë të bëjnë me politikën ose me aktivitetet e Institutit të

Statistikave apo me çfarëdolloj çështjeje tjetër që lidhet me të dhe që nuk klasifikohen si informacione për publikim. Ndërkohë që ju duhet të shmangni çfarëdolloj sjelljeje në publik që mund të interpretohet apo të lidhet, në ndonjë mënyrë, me pozicionin tuaj në Institutin e Statistikave. Statusi i një të punësuarit në INSTAT kërkon rezervim dhe takt.

20.2 Më parë se t'i përgjigjeni apo të bëheni nismëtarë të një kontakti me shtypin lidhur me politikat apo me aktivitetet e INSTAT, apo për ndonjë çështje tjetër lidhur me të, ju duhet të këshilloheni me eprorin tuaj, i cili, si rregull, duhet të këshillohet me personin e autorizuar për komunikimin me median, më parë se sa ju të lejoheni që të realizoni kërkesën tuaj.

20.3 INSTAT është pronar e të drejtës së të gjitha materialeve të shkruara që ju prodhoni gjatë kryerjes së detyrës tuaj zyrtare dhe ka të drejtën që ta publikojë një punë të tillë në atë mënyrë që ajo e shikon të përshtatshme. E njëjta mënyrë miratimi kërkohet për punime të përgatitura gjatë kohës tuaj të lirë ose më parë se ju të ishit staf i Instituti i Statistikave, nëse tema e punimit tuaj lidhet me Institutin e Statistikave ose me aktivitetet e saj.

KREU V

KONFLIKTET E INTERESAVE

21. Konfliktet e interesave

21.1 Punonjësi i institucionit duhet të marrë masa konkrete, në përputhje me Ligjin Nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe Kodin e Procedurave Administrative, për parandalimin, shmangien dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave në ushtrimin e detyrave të tij.

21.2 Me konflikt interesi kuptohet gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të stafit, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

21.3 Në asnjë rast, mendimet, sugjerimet, propozimet, konkluzionet dhe vendimmarrja e punonjësit nuk duhet të jenë të paramenduara me qëllime përfitimi moral, profesional apo material, për vete apo për familjarët e tij.

21.4 Në asnjë rast, punonjësi nuk duhet të pranojë apo të kërkojë, në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë të mira materiale, dhurata, trajtime preferenciale, premtime, për vete apo për familjarët e tij, për shkak të funksionit që ai kryen. Në rastet e dhuratave protokollare, ato duhet të raportohen menjëherë pranë eprorit direkt ose strukturës së burimeve njerëzore.

21.5 Punonjësi, në rast se konstaton që gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, duhet të njoftojë eprorin, dhe më pas të vijojë me dorëheqje të arsyetuar për gjendjen e konfliktit të interesit. Në asnjë rast dorëheqja nuk duhet të shërbëjë si shmangie nga rastet komplekse apo raste të trajtuara mediatikisht.

21.6 Punonjësi duhet të veprojë gjithnjë në interes të Institutit të Statistikave dhe në mbështetje të Misionit të tij. Si të tillë punonjësit duhet të shmangin konfliktet – apo qoftë dhe shfaqjen e tyre – ndërmjet interesave dhe përgjegjësive të tyre të ardhura si pasojë e të qenurit pjesë e stafit të Institutit të Statistikave.

21.7 Në çdo rast që krijohen rrethana në të cilat, ushtrimi i detyrës bëhet i pamundur për shkak të konfliktit të interesave për punonjësën apo për personat e lidhur me të, ai duhet të

informojë me shkrim eprorin dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit.

21.8 Verifikimi i situatave të ndryshme, të cilat mund të konsiderohen si konflikt interesash bëhet nga një komision i caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT. Ky komision përpilon raportin për kualifikimin e rrethanave përkatëse (nëse përbëjnë ose jo konflikt interesash) dhe e paraqit më pas tek Drejtori i Përgjithshëm.

22. Detyrimi për të deklaruar informacione mbi veten

22.1 Punonjësi duhet të tregojë çdo interes biznesor apo financiar që ka ai apo një anëtar i afërt i familjes së tij (sipas përcaktimit në pikën 15), i cili mund të jetë në konflikt të dukshëm me detyrat që mbulon në Institutin e Statistikave. Punonjësi duhet të deklarojë gjithçka tek eprori ose tek personi i caktuar zyrtarisht për probleme të tilla. Eprorët ose zyrtarët përkatës duhet të bëjnë një material të shkruar mbi këto informacione për të vërtetuar deklarin e bërë nga punonjësi në fjalë.

22.2 Nëse punonjësi është i pasigurtë lidhur me faktin se sa përputhet informacioni i deklaruar prej tij me atë që detyrohet të deklarojë, duhet të kërkojë shpjegime të mëtejshme në Sektorin e Burimeve Njerëzore. INSTAT, mund të kërkojë që disa kategori të stafit të tij, të deklarojnë në mënyrë periodike dhe konfidenciale (të rezervuar) në dosjen e tyre të gjitha aktivitetet dhe interesat financiarë sipas një forme (modeli) të miratuar paraprakisht. Këto deklarime analizohen nga një person i ngarkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT.

KREU VI

ETIKA E TITULLARIT TË INSTAT, STANDARDET BAZË TË SJELLJES DHE INTEGRITETI PERSONAL

23. Drejtori i Përgjithshëm si titullar i INSTAT

23.1 Drejtori i Përgjithshëm, si titullar i INSTAT-it, synon të përcjellë vlerat më të larta dhe të realizojë misionin e institucionit me qëllim forcimin e mëtejshëm të integritetit, transparencës dhe profesionalizmit.

23.2 Drejtori i Përgjithshëm njeh dhe zbaton pa asnjë kusht rregullat e përcaktuara në këtë Kod Etike, duke marrë masat e nevojshme dhe mundësuar stafit drejtues një imunitet të fortë ndaj konfliktit të interesit dhe sjelljeve në dëm të interesit publik si dhe për të përmirësuar kulturën e ndërgjegjësimit të stafit mbi zbatimin e parimeve themelore të etikës.

23.3 Drejtori i Përgjithshëm kujdeset periodikisht për të siguruar zbatimin e parashikimeve të këtij Kodi, duke kontaktuar drejtpërdrejtë dhe kryesisht me Strukturën Mbikëqyrëse të Etikës.

23.4 Drejtori i Përgjithshëm duhet të synojë zbatimin e standardeve dhe eksperiencave më të mira të administratës publike në lidhje me parimet e mirësjelljes dhe kulturës së komunikimit

ndërmjet nëpunësve të INSTAT. Ai duhet që, nëpërmjet sjelljes së tij, të motivojë punën dhe përkushtimin e stafit për kryerjen sa më mirë të detyrave të ngarkuara.

24. Ndershmëria dhe paanshmëria

24.1 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sillet gjithnjë në mënyrë që të ruhet dhe të rritet besimi i qytetarëve në ndershmërinë, paanshmërinë dhe efektivitetin e punës në Institutin e Statistikave.

24.2 Ndershmëria dhe paanshmëria përkufizohen si sjellja e Drejtorit të Përgjithshëm, në mënyrë të ndershme dhe të paanshme, pa u ndikuar nga interesat e tij private dhe pa bërë diferencime gjatë ushtrimit të detyrës publike dhe pa vënë në dispozicion asetet dhe burimet e INSTAT për qëllime të tjera jashtë natyrës së veprimtarisë së institucionit.

25. Mosdiskriminimi

25.1 Drejtorit të Përgjithshëm, gjatë ushtrimit të detyrës, i ndalohet çdo lloj diskriminimi lidhur me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë ose me çdo shkak tjetër, ndaj punonjësve të INSTAT-it.

25.2 Gjatë ushtrimit të detyrës, Drejtorit të Përgjithshëm nuk i lejohen veprimet ndaj punonjësve, si më poshtë vijojnë:

- Sjelljet fyese;
- Sjelljet armiqësore ose denigruese;
- Përdorimi i sharjeve dhe i shakave;
- Krijimi i lehtësirave/pengesave të pajustificuara;
- Komentet lidhur me mënyrën e jetesës ose çdo shkak tjetër që mund të përbëjë diskriminim;
- Kërkesa të pajustificuara gjatë ushtrimit të detyrës;
- Krijimi i konfidençave me persona të caktuar, të cilat mund të dëmtojnë interesat e personave të tjerë.

26. Daljet në publik

26.1 Drejtori i Përgjithshëm, në daljet në publik, duhet të jetë i sinqertë në atë që thotë “fjalët besohen dhe njerëzit krijojnë besimin”. Ai duhet të ofrojë bashkëpunim dhe të sigurojë bashkëpërgjegjësi për gjithçka thuhet apo realizohet në një përmbajtje komunikimi, duke siguruar arritjen e ekuilibrave në situata të ndryshme, në varësi të mënyrës së të thënit të gjërave.

26.2 Drejtori i Përgjithshëm është i suksesshëm në komunikim atëherë kur etika në të folur e ka kryer efektivitetin, vërtetësinë dhe besueshmërinë e mesazhit që përçon. Ai duhet të

mënjanojë thirrjet me emra dhe format tjera ofenduese gjuhësore (p.sh. gjinia tjetër, gjinia e dobët etj.).

26.3 INSTAT është pronar i të drejtës së të gjitha materialeve të shkruara që Drejtori i Përgjithshëm prodhon gjatë kryerjes së detyrës së tij zyrtare dhe ka të drejtën që ta publikojë një punë të tillë në atë mënyrë që ai e shikon të përshtatshme.

26.4 Njoftimet për median që kanë të bëjnë me politikat ose me aktivitetet e Institutit të Statistikave apo me çfarëdolloj çështjeje tjetër që lidhet me të, përgatiten dhe/ose këshillohen me personin e autorizuar për komunikimin me median.

27. Pavarësia

27.1 Në përputhje me ligjin “Për statistikat zyrtare” Drejtori i Përgjithshëm, kur ushtron pushtetin dhe kryen detyrat që i janë ngarkuar, nuk duhet të kërkojë ose të marrë udhëzime nga institucionet qeveritare, njësi të tjera publike qendrore ose vendore për përmbushjen e këtyre detyrave. Ai, gjithashtu, nuk duhet të ndikohet nga çdo subjekt tjetër që kërkon të influencojë tek ai për të ndërhyrë në veprimtarinë e Institutit të Statistikave.

27.2 Ndjekja e parimit të pavarësisë të Drejtorit të Përgjithshëm, është e papajtueshme me kërkimin, me marrjen ose me pranimin nga çdo burim tjetër, të ndonjë përfitimi apo edhe të ndonjë shpërblimi në këmbim të një shume financiare (qoftë edhe në formë dhurate), që mund të jetë përfituar nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm, si pasojë e postit që ai ka në hierarkinë vendimmarrëse të Institutit të Statistikave.

27.3 Çdo veprimtari tjetër e Drejtorit të Përgjithshëm, e cila kryhet jashtë detyrave të tij të përcaktuara në ligjin “Për statistikat zyrtare” nuk duhet të ketë ndikim negativ mbi detyrimet që ai ka ndaj Institutit të Statistikave dhe nuk duhet të dëmtojë imazhin e saj. Në artikujt shkencorë ose akademikë, Drejtori të Përgjithshëm duhet të qartësojnë se artikulli është hartuar personalisht dhe nuk përfaqëson qëndrimin zyrtar të Institutit të Statistikave.

27.4 Marrëdhëniet e Drejtorit të Përgjithshëm me grupe që përfaqësojnë interesa të tjera, nuk duhet të bien ndesh me pavarësinë dhe me integritetin që kërkon pozicioni i tij në Institutin e Statistikave.

28. Paanësia politike

28.1 Pavarësisht garancive organizative të miratuara për të minimizuar presionin politik, Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për vetë-identifikimin e situatave ku pikëpamjet personale politike mund të dëmtojnë pavarësinë profesionale të stafit të INSTAT dhe ku pikëpamjet dhe aktivitetet politike të punonjësve mund të vënë në rrezik reputacionin dhe besueshmërinë e punës së INSTAT-it.

28.2 Përfshirja në aktivitete politike mund të ndikojë në performancën drejtuese të Drejtorit të Përgjithshëm për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme si dhe dëmton imazhin dhe besueshmërinë e publikut në Institutin e Statistikave. Drejtorit të Përgjithshëm nuk i lejohet të anëtarësohet ose të marrë pjesë në aktivitete politike gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës si titullar i INSTAT. Pavarësia në dukje është aq e rëndësishme sa pavarësia faktike, në kuptimin e pjesëmarrjes në veprimtari politike publike, shprehjes publike të pikëpamjeve

politike apo kandidimit për zgjedhjen në funksione publike, të cilat mund të perceptohen nga palët e interesit si një ndikim në aftësinë e INSTAT-it për të prodhuar statistika të paanshme dhe transparente.

28.3 Gjatë orarit të punës dhe pas tij, Drejtori i Përgjithshëm nuk duhet të shfaqë, në mënyrë verbale apo nëpërmjet simboleve (veshje/aksesorë), bindjet e tij politike, si dhe nuk duhet të ndërmarrë asnjë veprim, i cili mund të konsiderohet si propagandë në favor të një ose disa partive politike.

28.4 Përpara dhe gjatë periudhave të fushatave zgjedhore, Drejtori i Përgjithshëm duhet të krijojë një strukturë monitorimi për të siguruar mospërfshirjen e stafit të institucionit në veprimtaritë e partive gjatë orarit të punës, si dhe për mosvënien në dispozicion të këtyre partive asetet dhe burimet e tjera që disponon institucioni.

29. Përdorimi dhe përhapja e informacioneve jopublike

29.1 Bazuar në ligjin Nr.17/2018 “Për statistikën zyrtare” kërkohet moslejimi i zbulimit ose i publikimit të informacioneve jopublike nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm. Kjo duhet të merret parasysh, veçanërisht, në fjalimet apo në deklaratat publike dhe në lidhjet me median, përse i përket publikimit të informacionit statistikor, që nuk është zbuluar ende zyrtarisht për publikun.

29.2 Drejtori i Përgjithshëm duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që edhe personat, që kanë mundësi njohjeje të informacioneve që ata zotërojnë, të respektojnë detyrimet e përcaktuara në ligj për moszbulimin apo publikimin e informacioneve jopublike.

30. Konfliktet e interesave

30.1 Drejtori i Përgjithshëm duhet të evitojë çdo situatë që përbën shkak për lindjen e një konflikti interesash. Një konflikt interesash lind atëherë kur Drejtori i Përgjithshëm ka interesa personale, tregtarë ose jo, të cilët mund të ndikojnë ose duket se ndikojnë në kryerjen e paanshme dhe objektive të detyrave të tij. Me interesa personale të Drejtorit të Përgjithshëm do të kuptohet krijimi i një përfitimi të mundshëm (potencial) për veten e tij, për familjen dhe për të afërmit e tjerë të tij me lidhje gjinie deri në shkallët e përcaktuara në dispozita të veçanta të këtij Kodi.

30.2 Drejtori i Përgjithshëm nuk duhet të përdorë, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, informacionin jopublik që disponon ose është në dijeni për shkak të detyrës, për të kryer apo për të drejtuar transaksione financiare personale, ai vetë apo nëpërmjet palëve të treta.

30.3 Drejtori i Përgjithshëm nuk duhet që, gjatë ushtrimit të detyrës dhe periudhës pas përfundimit të mandatit, të publikojë informacionet jopublike me të cilat është njohur gjatë kryerjes së detyrës të tij në Institutin e Statistikave.

KREU VII

AKTIVITETET E JASHTME DHE TË TJERA

31. Punësimi jashtë Institutit të Statistikave

31.1 Punonjësi i INSTAT nuk mund të ketë marrëdhënie tjetër punësimi, pavarësisht nëse është me shpërblim ose jo, pa miratimin paraprak, me shkrim, të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Statistikave.

31.2 Me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Statistikave, gjatë marrëdhënieve të punësimit, punonjësit mund t'i lejohet të angazhohet në veprimtari jashtë Institutit të Statistikave, me shpërblim apo pa shpërblim, në rastet:

31.3 Kur emërohet si anëtar në organet kolegjale të institucioneve shtetërore ose kur angazhohet si pjesë në organizma të tjerë publikë.

31.4 Kur angazhohet për mbajtje fjalimesh, për dhënie leksionesh, për mësimdhënie apo për shkrime që kanë lidhje me punën e tij.

31.5 Mësimdhënia, leksionet, fjalimet apo shkrimet, kanë lidhje me punën (shërbimin) e punonjësit atëherë kur:

- a) këto veprimtari kryhen si pjesë e veprimtarisë zyrtare të punonjësit;
- b) ftesa për t'u marrë me këto veprimtari, i bëhet punonjësit, kryesisht e në rradhë të parë, për shkak të pozicionit në Institutin e Statistikave;
- c) ftesa ose oferta për shpërblim bëhet nga personi apo subjekti interesi i të cilit lidhet me punën e punonjësit;
- d) informacioni që jep punonjësi, është kryesisht jopublik;
- e) subjekti që trajtohet lidhet ngushtë me punën që kryen punonjësi aktualisht ose është kryer deri një vit më parë;
- f) subjekti që trajtohet lidhet ngushtë me ndonjë program apo veprimtari të shpallur ose në vazhdim të Institutit të Statistikave.

31.6 Në asnjë rast, kryerja e kësaj veprimtarie nuk duhet të çënojë reputacionin e institucionit, të çënojë pavarësinë, dinjitetin dhe integritetin moral dhe profesional të punonjësit.

32. Aktivitete të tjera të jashtme

32.1 Punonjësi duhet të kërkojë lejen e Institutit të Statistikave për të patur një punësim, aktivitet biznesi apo profesion të lirë jashtë saj. INSTAT nuk do të kundërshtojë një aktivitet të tillë, i cili:

- a) nuk ndërhyr në aftësinë e punonjësit për të bërë në rregull punën e Institutit të Statistikave;
- b) është në përputhje me rregullat e Institutit të Statistikave lidhur me sjelljen e stafit të tij;
- c) nuk krijon konflikt interesash.

32.2 Kërkesa e punonjësit për të ushtruar një aktivitet të jashtëm duhet të jetë e qartë dhe duhet t'i dërgohet Sektorit të Burimeve Njerëzore së bashku me miratimin e eprorit direkt të punonjësit. Në disa raste, veçanërisht për aktivitete që lidhen me fjalime apo me publikime

jashtë Institutit të Statistikave, kërkesa e punonjësit ka nevojë që të bëhet e qartë edhe për Drejtorinë e Komunikimit dhe Publikimeve.

32.3 Punonjësit mund të marrë pjesë në aktivitete vullnetare të një bashkësie të caktuar apo në të tilla me karakter bamirës pa patur një pëlqim paraprak. Sidoqoftë, nëse punonjësi ka dyshime që një aktivitet ku ka ndërmend të marrë pjesë mund të jetë në kundërshtim me kriteret e sipërpërmendura, punonjësi duhet të konsultohet në njësinë përkatëse që monitoron zbatimin e marrëdhënieve etike para se të marrë pjesë në të.

33. Dhuratat, argëtimet, shpërblimet për punonjësit

33.1 Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Institutin e Statistikave, nuk lejohet që punonjësi të kërkojë ose të pranojë, drejtpërsëdrejti ose jodrejtpërsëdrejti, dhurata, shpërblime, favore, argëtime, kredi, hua ose çdo gjë tjetër, që ka vlerë monetare, nga persona ose subjekte që:

- a) kanë ose që kërkojnë të sigurojnë përfitime në procedurat administrative, në marrëdhëniet kontraktore ose në çdo marrëdhënie tjetër financiare me Institutin e Statistikave;
- b) kryejnë transaksione ose veprimtari të cilat mbikëqyren nga INSTAT;
- c) kanë interesa që preken në mënyrë thelbësore nga kryerja ose nga moskryerja e detyrave zyrtare të punonjësit të Instituti i Statistikave.

33.2 Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Institutin e Statistikave, punonjësi mund të pranojë artikuj ushqimorë në vlerë të vogël në raste jo të shpeshta. Përfitime të tilla lejohen edhe kur ofrohen në mbledhje, dreka ose darka, si pjesë e programit të veprimtarive të organizuara nga INSTAT.

33.3 Punonjësi nuk duhet asnjëherë që të kërkojë dhurata ose favore që kanë lidhje me detyrat e tij në Institutin e Statistikave. Si rregull, dhuratat që ofrohen, nuk duhen pranuar. Mund të pranohet një dhuratë e vogël simbolike, reklamuese ose inkurajuese. Por vlera e saj nuk duhet të jetë qartësisht më tepër se dhjetë mijë lekë. Në të tilla raste punonjësi mund ta mbajë dhe të mos e deklarojë atë. Nëse vlera e dhuratës mund të jetë më e madhe se dhjetë mijë lekë, ajo duhet të deklarohet së bashku me vlerën, e përafërt të saj. Dhurata mund të kthehet mbrapsht për një vlerësim nëse ka pikëpyetje lidhur me vlerën e saj.

33.4 Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Institutin e Statistikave, nuk lejohet që punonjësi të kërkojë kontribute nga punonjësit e tjerë për të bërë dhuratë për një epror, dhënien e donacionit për këtë të fundit ose të pranojë dhuratë nga punonjësi me pagë më të vogël.

33.5 Lejohet që punonjësi të marrë dhurata spontane të dhëna me dëshirë për rastet e veçanta si martesë, ditëlindje, dalje në pension, përfundim mandati ose raste ngushëllimi për vdekje apo për sëmundje. Këto lloj dhuratash si rregull, kufizohen vetëm në rrethin e ngushtë të bashkëpunëtorëve. Nuk lejohet që eprorët të kërkojnë kontribute nga punonjësit që janë nën mbikëqyrjen e tyre për çfarëdolloj rrethanash.

34. Nepotizmi

34.1 Punonjësit, të cilët ata vetë ose bashkëshortët e tyre janë gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve a të motrave) ose

krushqi e afërt (vjahërr, dhëndër, nuse, kunat, kunatë, thjeshtë, njerë e njerë), nuk lejohen të punojnë në Institutin e Statistikave.

34.2 Nëse punonjësi ka lidhje gjinie ose krushqie në raportet e përcaktuara në pikën 22.1 të këtij neni dhe është aktualisht i punësuar në Institutin e Statistikave, nuk lejohet që të punojë në ato njësi organizative:

- a) që kanë lidhje të vazhdueshme në ekzekutimin, procedimin dhe përfundimin e operacioneve të punës në Institutin e Statistikave;
- b) që nëpërmjet lidhjeve të sipërpërmendura të mund të krijojnë lehtësira, përfitime apo kushte përfitimi siç përcaktohet në këto rregulla.

34.3 Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Institutin e Statistikave, nuk lejohet që punonjësi të rekomandojë apo të ndikojë në procedurat e rekrutimit (punësimit) të stafit në Institutin e Statistikave, kur vendi i punës kushtëzohet nga lidhjet e gjakut si më sipër.

34.4 Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Institutin e Statistikave, nuk lejohet që punonjësi të marrë pjesë ose të influencojë në procesin e ngritjes në përgjegjësi dhe të ngritjes së pagës së punonjësit me të cilin ka lidhje si më sipër, në procesin e dhënies së shpërblimeve, dhënies së të drejtave për kualifikime e specializime apo të dhënies së çdo përfitimi tjetër.

34.5 Punonjësi është i detyruar të njoftojë eprorin, për rastet kur ka dijeni se në Institutin e Statistikave punojnë persona, me të cilët ju ka lidhje sipas përcaktimeve të mësipërme. Në këtë rast, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT mund të vendosë për transferimin e njërit prej tyre.

34.6 Nëse gjatë periudhës së punësimit në INSTAT krijohen lidhje gjinie ose krushqie si në raportet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ato i bëhen me dije Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, i cili mund të vendosë për transferimin ose jo të njërit prej tyre.

35. Zbatimi i orarit të punës

35.1 Punonjësi duhet që, gjatë marrëdhënieve të punësimit në Institutin e Statistikave, të përdorë në mënyrë efektive kohën e punës për punën e tij. Koha e punës nuk duhet përdorur për asnjë qëllim tjetër, përveçse në rastet kur përdorimi i saj për qëllime të tjera është i autorizuar në përputhje me ligjet dhe me rregullat në fuqi.

35.2 Punonjësit nuk duhet të kërkojnë, të inkurajojnë apo të lejojnë që vartësit e tyre të përdorin kohën e punës për qëllime të tjera, përveç atyre që kërkon detyra e vendit tuaj të punës dhe për të cilat keni një autorizim sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi.

35.3 Punonjësit nuk duhet të përdorin postin për përfitime private, për mbështetjen e ndonjë produkti, shërbimi ose institucioni financiar privat, të miqve apo të personave të tjerë të lidhur në marrëdhënie gjaku deri në shkallën e dytë. Gjithashtu, punonjësit nuk duhet të përdorin postin për mbështetjen e personave me të cilët janë lidhur privatisht (përfshirë këtu edhe subjektet jofitimprurëse).

35.4 Nuk lejohet që punonjësit të përdorin apo të lejojnë përdorimin e pozicionit, të titullit tuaj zyrtar apo të çdo lloj autoriteti tjetër që lidhet me funksionin e tyre, në mënyrë të tillë që të nxisin ose të shtrëngojnë ndonjë person tjetër, përfshirë edhe vartësit, që t'i bëjnë ndonjë favor financiar (ose të ndonji lloji tjetër), atyre ose miqve e personave me të cilët punonjësit kanë lidhje gjaku deri në shkallën e dytë, apo atyre me të cilët punonjësi është i lidhur jo zyrtarisht.

35.5 Nuk lejohet që punonjësi të përdorë postin zyrtar për të penguar veprimtarinë e të tretëve ose për t'i dëmtuar ata për arsye personale.

KREU VIII

STRUKTURA MBIKQYRËSE E ETIKËS

36. Struktura Mbiqyrëse e Etikës

36.1 Me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, përcaktohet Struktura Mbiqyrëse e Etikës, në përbërje të së cilës, dhe sipas hierarkisë është Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore dhe Drejtori i Financës dhe Projekteve, i ngarkuar me administrimin e burimeve njerëzore.

36.2 Struktura Mbiqyrëse e Etikës, rast pas rasti, por dhe në mënyrë periodike, i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, rastet e konstatuara në shkelje të Kodit të Etikës.

36.3 Struktura Mbiqyrëse e Etikës, në bazë të raportimeve, por dhe kryesisht, fillon procedurën disiplinore, në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi.

36.4 Çdo punonjës i institucionit, është i detyruar të bashkëpunojë dhe të raportojë pranë kësaj Strukture.

36.5 Për çdo rast të raportuar, apo të filluar kryesisht, Struktura Mbiqyrëse e Etikës duhet të përpilojë një raport të posaçëm, të cilin ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT në formën e njoftimit apo të propozimit për marrje masë disiplinore.

37. Deklarimi i njohjes së detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i rregullave

Çdo fillim viti, punonjësi duhet të plotësojë deklaratën e konfidencialitetit dhe një deklaratë ku të shprehet se i njeh dhe i zbaton detyrimet e përcaktuara në këtë kod, si dhe detyrimet e tjera që përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të miratuar të Institutit të Statistikave.

38. Dispozita zbatuese

38.1 Çdo veprim i ndërmarrë nga punonjësi, edhe nëse nuk parashikohet shprehimisht nga dispozitat e këtij Kodi, por ka efekt të njëjtë apo të ngjashëm, konsiderohet shkelje e këtij Kodi.

38.2 Shkelja e rregullave të përcaktuara në këtë Kod, në zbatim të plotë dhe të dispozitave të përcaktuara në ligjin për Statusin e Nëpunësit Civil, Rregulloren e Brendshme të institucionit, përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor.

38.3 Sektori i Burimeve Njerëzore është i detyruar ti bëjë të ditur punonjësit në çastin e punësimit detyrimet që rrjedhin nga ky Kod Etike dhe që parashikimet e tij duhen respektuar gjatë gjithë kohës së marrëdhënieve të punësimit në INSTAT.

39. Publikimi dhe hyrja në fuqi

39.1 Ky Kod Etike hyn në fuqi menjëherë dhe është i detyrueshëm për të gjithë punonjësit e INSTAT.

39.2 Kodi i Etikës publikohet në faqen zyrtare elektronike të INSTAT brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi.

39.3 Kodi Etikës i miratuar me Vendimin nr. 390 Prot., datë 13.03.2017 shfuqizohet.

BORDI DREJTUES

Miratuar më datët 23 Maj 2019